

Rush Dragu

KELMENDI ... dritë hije

- refleksione -



Shkodër, maj 2023

Rush Dragu

KELMENDI
... dritë hije
- refleksione -

Redaktor:
Merit Dragu

Korrektor:
Meritan Spahija

Grafika:
Abel Spahija

Copyright©: Rush Dragu

ISBN: 9789928382269



*Librin ia kushtoj mbeses sime Ariana Dragu,
e cila më ka bâ gjysh për herë të parë. Duke
mos pasë as motër dhe as vajzë, Ariana më ka
lumtunue shpirtin.*

I. KELMENDI

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM, HISTORIK, SHOQËROR, DOKET DHE ZAKONET

Komuna e Kelmendit, është një ndër pesë Komunat e Rrethit të Malësisë së Madhe. Është një krahinë e vjetër dhe e përcaktuar mirë nga ana gjeografike, entografike, me historinë e vjetër dhe të re të vet, qoftë të shkruar apo të dhëna brez pas brezi nëpër gojëdhënat e popullit e të brezave. Ajo shtrihet në veriun e sotëm gjeografik të Shqipërisë. Ka një sipërfaqe prej 351 km katror, me gjerësi gjeografike 42°39'30" dhe 42° 25'18" e me gjatësi gjeografike 19°30'12" dhe 19°50'. Në perëndim e në lindje Kelmendi kufizohet me Malin e Zi, ndërsa në Juglindje me rrethin e Tropojës dhe me Komunën e Shalës, kurse në Jugperëndim me Rapshën e Hotit.

Zona e Kelmendit është një nga "perlat" e rralla të virgjëra. Kelmendasit dallohen nga banorët e komunave të tjera të Malësisë së Madhe për veçoritë gjuhësore, kulturore, në veprimtarinë ekonomike dhe në organizimin e vjetër shoqëror. Kjo krahinë thirret me emrin *Malësia e Kelmendit* dhe vetë Kelmendasit e quajnë vehten malësor. Në kuptimin e fisit është ndër fiset më të mëdha të Malësisë së Madhe. Ka një shtrirje jo vetëm brenda kufinjve të sotëm administrativë të Shqipërisë, por dhe territoret administrative të ish-Jugosllavisë: Në Guci, Plavë, Vuthaj, Rugovë, Beranë, Rozhajë, Berde.

Zanafilla e Kelmendasve mendohet nga Ahmati që u vendos në Pshtan (vend në Juglindje të Tamarës, në krah të Cemit), nga martesja e tij lindi Klimenti, emër të cilin e mban krahina e sotme. Deri në çerekun e parë të shekullit XIX, fisi i Kelmendit ka qenë një bajrak (turqisht: flamur).

Më vonë, rreth vitit 1860, Kelmendi përbëhet nga katër bajraqe: Selca, Nikqi, Vukli, Boga dhe secili bajrak ka pasur të parin e vet, bajraktarin (flamurmbajtësi), i cili ishte person me rëndësi dhe i trashëgueshëm nga babai tek djali më i madh. Këto grupe ose bajraqe, e kanë fillësën nga katër vëllezër të quajtur respektivisht: Seli për Selcën, Nili për Nikqin, Vuli për Vuklin dhe Boli për Bogën. Secili bajrak është i përbërë nga grupe vëllaznore, familjare, që është përdorur përsëri fjala turke "mëhallë". Për mëhallët e Kelmendit brenda bajrakëve do të flasim më vonë në kapitujt e tjerë. Duke qenë një zonë gjeografikisht e fortifikuar nga malet, nga terreni i përshtatshëm për luftë mbrojtëse, gjë e cila i ka ndihmuar banorët e këtij vendi, tu bëjë ballë invazioneve turke, e si pasojë muslimanizmit të popullsisë së kësaj treve. Besimi fetar i banorëve të kësaj zone është ai katolik. Vetëm në Nikq, ka disa shtëpi të besimit musliman.

Gjatë luftrave, kërkesës së ushtrisë turke për ndërrimin e fesë, banorë, grupe familjare të tëra, për t'i shpëtuar turqizmit dhe barbarisë janë larguar. Rreth viteve 1700, Verdi Pasha shpërnguli shumë familje nga Nikçi dhe më pak nga Vukli, në drejtim të Vuthajve, Peshterës që pak sosh, sot mbajnë identitetin Kelmendas, mbasi egërsia sllave i ka sllavizuar ato.

Duke qenë në skaj të vendit, i rrethuar pothuaj në të gjitha anët me fise sllave, trualli Kelmendas është goditur shumë herët nga vala e Serbizmit. Dëshmi sot mbeten emrat sllavë të vendeve: Jasanov, Dobri, Lepushë, që shqipërohen: jam i ri, mirë, vend i bukur e shumë emra të tjerë. Në mossllavizimin e njerëzve, një rol shumë të rëndësishëm ka luajtur edhe kleri katolik, ku autoriteti i tij ka qenë i padiskutueshëm. Ai ka ndikuar në ndjenjën shqiptare të kombëtarisë për t'i rezistuar imponimit dhe barbarisë serbe. Për luftrat dhe përpjekjet për mbijetesë të shqipfoljes Kelmendase, janë dëshmi varret nëpër bjeshkë e gërxhe të malaziasve dhe serbëve të vrarë në luftë me Kelmendasit. Për ndjenjën e fortë të besimit flasin ruajtja e ikonave të vjetra nëpër shtëpi, ekzistenca e kishave të vjetra të Vuklit dhe Selcës. Nga trashëgimia gojore dhe të dhënat e pakta të shkruara në këtë trevë kohë mbas kohe, organizimi i vjetër dhe në përgjithësi organizimi dhe drejtimi shoqëror ka ndryshuar, ka evoluar dhe është përshtatur në përputhje me rrethanat dhe kushtet historike - shoqërore të krijuara.

Këto ligje të forta, zakone, tradita të forta të detyrueshme për t'u zbatuar me dëshirë apo me zor, shërbyen për të vendosur rregull dhe mirëkuptim në mes malësorëve, për të rregulluar marëdhëniet në mes tyre në të gjitha aspektet e jetës së tyre të përditshme. E thamë se çdo bajrak kishte të parin e tij ose siç quhej bajraktarin që drejtonte të gjithë jetën e fshatit. Ai ishte nga mëhalla më e madhe që kishte meshkuj më shumë, ishte post drejtues i trashëgueshëm. Në këto kushte autoriteti i tij herë bëhej absolut dhe herë të tjera nëpërkëmbej, mbasi zotësia e trashëgimitarit nuk ishte e plotë si nga pasuria dhe intelekti. Kështu në bajrakun e Selcës dhe Vuklit, për shumë kohë e deri në ditët tona, është e përcaktuar mëhalla që ka pasë bajraktarin. Në Selcë mëhalla e Pëllumbajve dhe në Vukël mëhalla e Vuksadedajve. Në Nikç, autoriteti i bajraktarit është disi më i zbehtë dhe për këtë mendohet nga ekzistenca në këtë fshat e dy feve, ecajaket dhe shpërnguljet e detyruara, banorë pak dhe diferencimi klasor i vogël.

Krahas bajraktarit nëpër bajraqe dhe këshilli i pleqve, anëtarët e të cilit kanë dalë nga mëhallat e kryesisht nga ato më të mëdhatë në bajrak. Këto këshilla kanë nxjerrë ligje, urdhëra, kanë gjykuar rastet, gjaqet dhe kanë vendosur gjoba, e kanë dënuar damtarin dhe çdamtuar të damtuarin. Ligjet kanë ndryshuar sipas zhvillimit ekonomik e shoqëror, por për kohën kur kanë ekzistuar kanë qenë fuqiplotë. Si në mbarë Malësinë dhe në Kelmend ka ekzistuar problemi i gjakmarrjes, megjithëse më pak i mprehtë, por prapëseprapë ka ekzistuar. Kështu për zbutjen e këtij fenomeni dhe të masave ndaj gjakësve dhe të afërmeve të gjaksit, lindi nevoja për përmirësime në "Ligjin e Marrjes së Gjakut".

Me 16 Shtator 1902, Bajraku i Vuklit diskuton këtë problem dhe vendos që: "Gjakmarrja të bëhet vetëm brenda familjes së vrasësit". Kjo u shtri më vonë edhe në bajraqet e tjera të Kelmendit. Më parë në Selcë, e më vonë në bajraqet e Nikçit (Brojë e Rahovicë). I këtyre viteve është edhe Usulli i Selcës, por që ka një gjerësi më të madhe me ligje: Ai për damtarin, për verimet, për dimnishtat, për drekët e martesat. Ishte caktuar data fikse për të gjithë fshatin për të shtegtuar për në bjeshkë me bagëti. Për atë që dilte para kohe gjobitej me 10 okë djathë, ose tetë okë mish, etj, për arsye se u kulloste barin (mallesën) të tjerëve me parregullsi).

NJË I HUAJ SI KRIJUESI I KELMENDASVE TË SOTËM

Sipas zanafillës dhe variاني më popullor, i pari i Kelmendit është Ahmati, i cili e ka varrin në Pshtan, një vend në të majtë të Luginës së Cemit në të hyrë të Kelmendit përballë Rahovicës. Por për Kelmendin ka disa variante që orvaten të ti afrohen një të vertete së kurë dhe nga kush është krijuar kjo krahinë.

Kudo neper malesina, jo vetem në Shqiperi është e veshtirë ose e pamundur të përcaktohet në një mënyrë pak a shumë e saktë, vendi ka ka ardhur i pari tyre, kështu që studiuesit dhe hulumtuesit e ndryshem detyrohen të marrin në konsideratë hamëndsimet ose të dhenat gojore të njerzeve të afte për të mbajtur mend dhe treguar lidhur njera me tjetren ngjarjet e personazhet.

Shumë shqiptare e nder ta së shumti kelmëndas pretendojnë se popullsia është vendase dhe pikrisht i pari i tyre është Kolë Mendi (që shqiperuar do të thote Kola i Mençur) dhe prej tij vjen emri Kelmënd.

Varianti më i perdorur nga historishkruesit e krahinës është ajo që është ma e formuluar mirë është e At Gabrielit. Ai mendon (At Gabrieli) se i pari nga kanë ardhun kelmëndasit është një i huaj (jo shqiptar). Ai ishte një mergimtar Italian nga Republika e Venedikut i cili kishte jetuar me parë në Dalmaci apo në Hercegovinë të cilat ishin nën pushtetin e Republikës së Shen Markut (Venedikut). Ai kishte jetuar si kujdesatr i nje famulltari diku në Moraçë. I merzitun dhe lodhun nga sjellja despotike e famulltarit mori i rrugen e ikjes, vetem për ti shpetuar jetes plot mërzi me famulltarin. Në një vend të quajtur Bardhaj të Trieshit ai takon nje bari me tufat e tij të dhenve. Ishte vendali qe sipas gjasave do të ketë qënë nga Trieshi.

Bariu gezohet qe takoj një njeri i veshur me rroba murgu, e pyeti se nga vinte dhe per ku ishte duke shkuar. Klementi pa i thënë atdheun e tij se prej nga ishte i rrefeu vetem vuajtjet që kishte kaluar me famulltarin në Moraçë dhe pastaj i tregoi bariut se kishte vëndosun të shkonte në Shkoder, për të gjetë ndonje punë apo për të sherbyer diku që do të trajtonin mire e të kishte një fitim sado të vogel me përballua jetën.

Bariu aso kohe kishte nevojë për barinj e puntor mbasi femijet i

kishte të vegjel, vetem një vajze të cilen e kishte me gruan e parë që i pati vdekur kohe më parë. I tha Kelëmnidit të qëndronte në shtëpinë e tij dhe do ta punësonte si bari mbasi kishte nevojë se femijet i kishte të vegjël. Ai kishte numer të madh bagitshë e toka të shumta, ishte martuar dy here, me gruan e parë kishte pasë një vajze të quajtur Bubçë nëna e saj kishte gjatë lindjes së saj. Ajo ishte e çale dhe jo e shume e bukur. Ndërsa me gruan e dytë kishte shumë femije. Grua e dytë kishte rritë Bubçen por edhe e donte dhe e respektonte mbasi i ishte bërë krah për të rritur fëmijet e saj. Edhe pse Klemënti vazhdonte të ishte korrekt me punën si bari dhe të zbatonte më përpikmëri porositë e pronarit, ai ra si padashur në "gracken e dashurisë" së Bubçes e cila mbeti shtatzënë me Klemëndin. Kurë e mori vesh e shoqja e pronarit u alarmua mbasi kishte frigë se do ta vriste Klemëndin për turpin që i kishte sjellë duke i çnderuar të bijen pa kunore martese me Bubçen. Ajo i bjen hiles dhe i del para tragjedisë duke e vënë në prove dhënjë bejë "për natën e Shen Kollit" se nuk do e prekë Kelmëndin. Ai e pranoi që ti zboj nga shtëpia duke i dhënë qingja dhe dele për pagesën e punës që kishte bërë gjithë atë kohë qëndrimi në pranën e tij.

Kelmëndi dhe Bubça vëndosen në një shpat mali i quajtur Pshtan, ku krijojnë jetsen e re. Ky vënd ndodhet poshtë Bardhajve të Trieshit në krahun verilindor të shpatmalit mbi lumin Cem. Sipas Hyacinthe Hecquard, konsull francez në Shkoder. Kalorës i Legjionit të Nderit thuhet se femija i pari i Kelmëndit dhe Bubçës ka lindë djalë të cilit i vunë emrin Abati N'dovi ndersa djali i dytë u quajt Boga.

Nga N'dovi lindën tre femijë; Zek N'dovi i cili është themeluesi i Selcës, i dyti Gjon N'dovi i cili është themeluesi i Vuklit, i treti Nik N'dovi dhe konsiderohet themeluesi i Nikçit. Ndersa femija i dyte i Kelmëndit Boga është krijuesi i Boges që bën pjesë në malësinë e Kelmëndit dhe vëndoset ndermjet maleve të Kelmëndit, Dhkreilit, Kastratit dhe Shales.

ATA QE I DHANE FORMË HISTORISË SË KELMENDIT

Emri i Kelmendit vjen nga fjala latine Clemens (- tis), i cili do të thotë: i urtë, i mirë, i thjeshtë. Si emër i njeriut e takojmë te zëvendësi i Shën Pjetrit, Papa Klementi i I - rë (viteve 90 - 101) i cili është martirizuar duke predikuar fjalën e Krishtit. Në këtë vend mbahet si shenjt dhe është festuar si festë lokale e bajrakut të Selcës. Kisha e re e ndërtuar nga financimi i diasporës Kelmendase me banim në Amerikë në fshatin Vukël në vitin 2001, mban emrin e Shën Kelmendit.

Në vitin 1582, Kelmendi kishte vetëm 70 shtëpi, kjo si rrjedhojë e shpërnguljeve të shumta e banorëve vendas, nga invazioni i pushtuesve aziatikë. Me 8 Korrik 1634, sipas Ipeshkvit të Sapës, Gjergj Bardhit, Kelmendi numëronte 300 shtëpi me 3200 banorë.

Në vitin 1702 sipas një relacioni dërguar Selisë së Shenjtë nga Arqipeshkvi i Shkupit Pjetër Karagaqi, 274 shtëpi kelmendase si pasojë e represionit Islam u detyruan të shpërngulen në drejtim të Novi Pazarit, Rugovës, Pshterës. Po kështu shpërngulje pa kthim të Kelmendasve ka edhe në drejtim të Plavës dhe të Gucisë.

Në vitin 1878, që përkon me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në të cilën kanë marrë pjesë dhe Nik Lek Pepa dhe Ujk Gila (që të dy Seljanë), Kelmendi kishte vetëm 2010 banorë, ndërsa në vitet e shpalljes së 1912 - tës popullsia e Kelmendit ishte 2400 banorë dhe 3 % e kësaj popullsie ishte myslimanizuar. Popullsia që kishte pranuar myslimanizmin e vet, ishte kryesisht nga bajraku i Nikçit.

Në vitin 1916, ka një regjistrim të saktë të popullsisë. Në bazë të fshatrave të asaj kohe tregojnë: Selca 852 banorë, Vukli 712 banorë, Nikçi 685 banorë, Boga 227 banorë. Në këto të dhëna janë përfshirë dhe fshatrat e rinj të sapo populluara: Tamara, Vermoshi, Broja dhe Budaqi e Gropat e Selcës. Lepusha i përket popullimit të viteve më vonë.

Sipas dokumenteve të kohës del se Kelmendi ka lindur rreth vitit 1174. Dorëshkrimet më të hershme për Kelmendin janë nga Stefano Gasperi (1671) visitor apostolik i Vatikanit. Pastaj është një përshkrim i gjatë i Pjeter Bogdanit (1625-1689) paraqitur kardinalit Cibo. Ndërsa

Hekardi (1814-1866) paraqet te plote gjenezen e të parit Kelmendit. Po ashtu studiuesi johan Georg von Hahn nderton pershkruan hollësisht vëndin e parë ku linden të paret kelmëdas.

Albanologu Baron Franc Nopça (1897-1933) është një vëzhgues i hollësishëm për ecurinë e zhvidhimit breznor të parvë në Kelmënd.

Gazetaria dhe studiuesja e cila shkeli pellëmbë për pëllembe Kelmëndin Edith Durham i përket kohëve të vona dhe më të reja por që ka referënca gojore dhe historike që i bashkëlidhe me pararendësit e saj është një kompleks më i plotë panoramik për nga thedhësia dhe gjërësia e mendimit historiko shkencor për Kelmëndin.

Në vitin 1662 Evlia Çelebi (1611-1685) kronikani i ekspeditave turke, i cili udhëtoi nëpër Shqipërinë e veriut përmend Kelmëndin si "fisi i pafe Klemente ose Kelmëndi"

Në raportin kishtar, Pjetro Stefano (Gaspri) në vitin 1671 ka shkruar formen Clementi (për Kelmëndin). Po ashtu në hartat e venedikasve Françesko Mario Koroneli në vitin 1688 dhe po në hartat e hartografit tjetër Italian Gacomo Kantelli da Vinioala me 1689 përdoren emrat Klmenti, Klemen, Klimneti mbasi më pare emri Clementi ishte i njohur për Evropën Perëndimore dhe po të verehen të gjitha bëjnë fjalë për Kelmëndin si zone gjeografike.

Në dokumentat e Vatikanit thuhet se qyshe nga viti 1651 ekziston Kisha Katolike e Klementit në Vukel. Mbrojtësi i shenjët i tyre ishte Shën Mëria e Virgjër e quajtur "Zoja e Vuklit" që festohet me 24 maj. Në keto vite kanë sherbyer në këtë kishë Patres Reformati, Atë Leoni nga Citadela dhe Fra Angjelo nga Milano. Në dokumentat e kohës thuhet se kisha ishte e lyer me gelqere dhe nuk është e suvatuar, por e mbuluar me dërrasa. Ajo mbahet mjaft mirë dhe vazhdoen rregullisht sherbimet e shenjta. Sherbimet e përditëshme fetare ketu nuk janë ndaluar, ndonëse ekzistonte rreziku nga turqit, shkruan vizitori apostullor në Shqipëri, Pjetro Stefano Gaspari, i cili udhëtoi nëpër këtë rajon, më 1671-1672.

Ndersa Famullia e Selcës u themelua me 1737, kur u regjistruan lindjet dhe vdekjet e para nga kisha katolike në këtë vënd.

Marino Bolica, shkrimtar venedikas me 1614 shkruan se: "fisi i Klementit përbëhet prej 187 shtëpive me rreth 650 luftetar të gjithë të

armatosun, nën komanden e Smajl Ptrentaseut dhe Bedasuçes. Ata janë njerëz të rreptë, të paepur, të guximshëm dhe si grabitqar të medhenj. Janë të etur për territore"

Të dhënat për popullsinë janë zakonisht referenca kishtare dhe të ndonjë kronikani lufte të kohës. Kështu Gjergj Bardhi me 1634 peshkop i Sapës shkruan se Kelmëndi kishte 300 shtëpi dhe 3200 banorë.

Josef Myller doktor austro-hungarez duke ju referuar Pater Dedes së Vuklit thotë se Kelmëndi me 1837 kishte 4200 banorë.

Me 1841 princi Nikollaj i Vasojeviqve thotë ndër të tjera se Kelmëndi kishte 500 burra të armatosur shumë mirë. Konsulli francez në Shkodër, Emil Viet me 1866 shkruan se Kelmëndi kishte 510 shtëpi dhe gjithësej 3263 banorë.

Rregjistrimi më i besueshem dhe i pari i organizuar nga një institucion shtetor është me 1918 nën administrimin e austro-hungarise, aty shkruhet se Kelmëndi kishte 779 shtëpi me 4679 banorë. Ketu përfshiheshin bajrakët e Vuklit, Selces, Nikçit dhe Boges. Popullsia jetonte në Nikç, Vukel, Selce, Vërmosh, dhe më vonë Kozhnja është populluar nga banorë të ardhun nga Vukli dhe Nikçi dhe një fis nga Dibra e Madhe, tanazajt (për arsye gjaku) pastaj Kalca me banorë nga Nikçi, Broja me banorë nga Nikçi, Grabomi me baorë nikças dhe seljane. Ndërsa Tamara me 1 shtëpi dhe Qendra administrates. Ndërsa Pojata e sipërme dhe ajo e poshtme nga seljanë që deri atëherë sherbenin si kullota dimnore për seljanet, pas vitit 1945 do të zhvendoset qendra nga Ura e Tamares dhe do të jetë në Velebike, aty ku është Qendra e sotme (viti 2020). Kelmëndi ishte dhe është zonë katolike megjithëse një pakicë është konvertuar dhe ka kaluar në fenë islame gjatë sundimit turk. Kontributor të rëndësishëm për historografinë e Kelmëndit kanë dhe studiuesit me emer, Nikë Ukgjini, Injac Zamputi, Donat Kurti, Marin Sirdani, Rrok Zojzi, Selami Pulaha.

Në vitet mbas 1990-es studiues të tjerë do të përpiqen të sjellin me të sistemuara ngjarje, data e personazhe nga thellesia e historise për Kelmëndin, ku mund të përmëndim, "Malësia e Kelmëndit" Kole Progni, "KELMENDI ...drite hije" nga Rush Dragu, "Brezni te Kelmendit" Gjovalin Gjelogshin, "Prek Cali-Kelmendi dhe kelmëndasit"Luigj Marini, "Forca e Kelmendit" Zef Naçaj, "Rrënjet e Kelmëndit-Nikçit, Bogës

e Vuthajve" Gjon Vuksani, "Kelmëndi -në mjegullnajt e historise" Nikollë Shyti, "Lufta e Kelmëndit" Ndoc Vulaj, "Velipoja" Pjeter Sokoli, "Kelmëndi vështrim gjeografik e turistik" Gjovalin Gruda dhe Selman Sheme. "Kelmëndi në vargjet e mija" Gjovalin Lumaj

Statistika e meposhte është nxjerrë nga regjistrat e Gjendjes Civile Tamare e cila kishte në juridiksionin e saj zonen Kelmënd me tetë kryepleqesitë, organizim i pushtetit lokal per vitin 2000. Keto ishin, Vermoshi, Lepusha, Selca, Tamare, Broje, Kozhnje, Vukel, Nikç.

VËSHTRIM PËR PESË FSHATRA TË KËLMENDIT

SELCË
Fshati Selcë shtrihet në lartësinë 353-1100 m mbi nivelin e detit. Ky fshat ndodhet 8 km në veri të qendrës së komunës Kelmend. Selca është fshati i bukurive të fshehura. Përgjatë rrugës së makinës ai duket si një fshat i varfër por nuk është kështu, ai fsheh bukuri të shumta jo vetëm natyrore. Në Selcë gjendet kanioni më i madh i Kelmendit, ujvara më e bukur, shumë shpella për t'u eksploruar, shtigje malore interesante, peisazhe shumë të bukura për t'u fotografuar, vende historike, shtëpi me arkitekturë të veçantë, punime artizanale të veçanta të lëkurës, drurit, gurit etj, etj. Thuhet se emri i këtij fshati është trashëguar nga një paraardhës i banorëve që quhej Seli. Drejtimi kryesor i ekonomisë është blegtoria. Mes fshatit kalon lumi Cem i Selcës. Në këtë lum, gjatë muajve Prill - Maj, mund të zhvillohet rafting për profesionistë. Gjatë rrugës së tij ky lum çan luginat e malet duke formuar kanionin e Gerrles (900 m i gjatë dhe 25 m i thellë), i cili shfaqet mes shtëpive, arrave dhe vende vende ngushtohet shumë. Ujvara e Slimës dhe sidomos Ujvara e Sllapit janë kryevepra të natyrës. Nga veprimtaria karstike janë formuar shumë shpella si: Shpella e Pogonicës, Shpella e Gradës, Shpella e Rrugës, Shpella e Vlljakut, Shpella e Pajës, Shpella e Turçinit, etj. Në Selcë, në lagjen Pepaj, si rezultat i veprimtarisë erozive në disa shkëmbinj janë "gdhendur" lloj - lloj formash të veçanta. Këto shkëmbinj njihen me emrin

"Karramanet". Gjithashtu shumë interesante janë ulluqet shkëmbore, Gërdhata e Vilës dhe Jeshnicës, burimet e ujit Gurra e Zanës, ujët e Kritis etj. Pasuri tjetër natyrore është Bjeshka e Jeshnicës, e cila përbën një nga qendrat më të mëdha blegtorale të Alpeve perëndimore. Në Selcë gjenden monumente të veçanta natyrore si lëndina e Greçës, e mbuluar me lule shumëngjyrëshe dhe bimë mjekësore si: salepi, teukel, çaji i malit, etj. Në mes të kësaj lëndine është një tjetër monument natyre ahu i Greçës. Ky ah, gjithashtu është një vend i rëndësishëm historik për Shqipërinë pasi këtu më 1911 u mbajt Kuvendi i Përgjithshëm i Krerëve Shqiptarë, të cilët nënshkruan memorandumën me 12 pika drejtuar portës së lartë. Vende të tjera historike janë Qafa e Këstecit dhe Suka e Mkushit, ku u zhvillua beteja kundër turqve. Malësorët janë shquar për burra trima dhe të fortë. Forcën e tyre e dëshmon më së miri një rrasë guri, e cila peshon rreth 400 kg. Ajo njihet si Rrasa e Shtjefnit, dhe ka marrë emrin e burrit, i cili e ngriti atë deri në bel. Shtëpitë këtu janë 1-2 katëshe prej guri, me çati të mbuluara me tjegulla të kuqe. Karakteristikë e tyre, ndryshe nga fshatrat e tjerë, është ballkoni i gjatë, që shtrihet gjatë gjithë pjesës së përparme të shtëpisë. Ky fshat ka lindur dhe rritur artistë të penës dhe të daltës. Mjeshttrat më të mirë të punimit të lëkurës, gdhendjes së drurit dhe gurit gjenden këtu. Punimet e tyre frymëzohen nga bukuria femërore, natyrore, gjithashtu kanë motive historike e fetare. Një suvenir i tillë do të ishte një kujtim i bukur nga Kelmendi. Festa e fshatit është Zoja Rruzare, e cila festohet në datë 07 Tetor. Kjo festë festohet me shumë miq, të cilët vijnë nga Kelmendi e më larg që në datën 06 në darkë, të cilët festojnë gjatë gjithë natës, me një mikpritje të madhe siç e ka pasë dhe e ka traditë Kelmendi. Ditën e nesërme, që është dita e festës, mbledhen të gjithë bashkë miq dhe banorë për të marrë pjesë në kremtimin e meshës tek kisha e këtij fshati. Shumë interesante është kjo kishë, ku në oborrin e saj në një trung pemë të gjallë është i gdhendur trupi i Jezu Krishtit. Në këtë fshat do të gjeni Bar-Kafe të vogla si dhe një rezervat trofte.

TAMARE

Fshati Tamare është qendra administrative e komunës Kelmend. Ky fshat shtrihet në një lartësi rreth 280 m dhe gjendet aty ku bashkohen

ujrat e lumit Cem të Selcës dhe Cemit të Vuklit. Fshati ka marrë emrin nga Tamara, gruaja e Vezirit të Shkodrës në shek XVIII. Klima është e butë, rrallë bie dëborë. Përreth këtij fshati ngrihen male të thepisura, duke i dhënë fshatit pamjen e një grope të thellë. Kthjelltësia e lumit Cem dhe gurët e bardhë, që ka përpunuar gjatë rrugës së tij, ia shtojnë bukurinë fshatit. Në Tamare mund të argëtoheni duke peshkuar troftë, duke vajtur për gjueti kafshësh të egra, ose dhe duke pirë një birrë të mirë Tamara në shoqërinë e rrëfimeve interesante të banorëve. Me ndihmën e zyrës së informacionit, që ndodhet në këtë fshat, do të shijoni në maksimum eksperiencën tuaj në këtë fshat dhe në tërë Kelmendin. Fshati i Tamares është një fshat i ri. Ai mori emrin nga gruaja e Vezirit të Shkodrës, e cila tek po kthehej nga Mali i zi ku kishte vajtur të shikonte njerëzit e saj, mbeti në fshat (atëherë kullota e Selcës) sepse ujrata e rrëmbyeshëm nuk lejonin kalimin mbi urën e vjetër, që gjendej mbi të. Kështu Veziri i Shkodrës dha para për ndërtimin e urës së re, një urë me dy qemere, ku qemeri më i lartë është 13 m. Ura që u ndërtua u quajt ura e Tamares dhe më vonë këtë emër mori dhe fshati. Malet e thepisura të këtij fshati janë të pasura me florë të shumëllojshme dhe bimë mjekësore si: shërbelë, trumza, bliri, balsami, etj. Mbledhja e këtyre bimëve mjekësore është një burim të ardhurash për banorët e këtij fshati. Përveç florës së pasur, malet e këtij fshati janë një strehë e shumë kafshëve të egra si dhitë, derrat, lepujt, kaprojtë, etj. Pranë lumit Cem mund të bëni foto shumë të bukura por dhe mund të peshkoni troftën e egër të lumit, e cila është shumë e shijshme. Në Tamare gjenden një sërë shpellash karstike dhe në disa prej tyre janë gjetur gjurmë banimesh të hershme. Një ndër shpellat më të bukura është shpella e Malqe Grudës.

Arkitektura e shtëpive në Tamare u ngjan më shumë atyre të qyteteve të veriut të Shqipërisë. Ngaqë banorët e këtij fshati janë të ardhur nga fshatrat e Kelmendit si dhe nga Trieshi, nuk festohet një festë e përbashkët, por festohen tri festa Zoja Rruzare në datë 07 Tetor, e cila festohet nga banorët e ardhur nga Selca, Zoja Ndihmëtare në datë 24 Maj, që festohet nga banorët e ardhur nga Vukli dhe Zoja e Triesh*t, e cila festohet çdo të dielë të parë të Tetorit, për ata të ardhur nga Trieshi. Në këtë fshat mund të akomodoheni në shtëpi pritëse. Këtu do të gjeni bar kafe, restorante, qendra interneti, dyqane suveniresh dhe produkte ushqimore bio të Kelmendit.

Në zyrën e informacionit turistik mund të informoheni për atraksionet turistike, itineraret interesante, do të gjeni guida, harta të vlefshme, etj.

VUKEL

Është ndër fshatrat që Mary Edith Durham e konsideron magjepës. Gërmimet arkeologjike dëshmojnë për një banim të këtij fshati që në periudhën e neolitit. Ky fshat shtrihet në lartësi 525- 1150 m, 18 km larg fshatit Tamare, qendrës së komunës Kelmend. Klima relativisht e butë në luginën e Vuklit ka krijuar kushtet e favorshme për gjallërimin e një vegjetacioni të shumëllojshëm. Këtu do të gjeni bimë mjekësore, shumë lajthi e arra, kullota të bukura alpine etj. Të apasionuarit pas eksplorimit të shpellave do të gjejnë në Vukël shumë shpella interesante. Burime ujore, monumete natyre ju presin që t'i vizitoni e t'i fotografoni. Peisazhi natyror, jeta e thjeshtë blegtorale e banorëve do ju bëjnë të ndjeheni një me natyrën dhe të harroni qytetet e zhurshme. Mendohet se emri i fshatit Vukël vjen nga emri i banorit të parë me emrin Vuli. Banimin e hershëm të fshatit e dëshmojnë gjetjet arkeologjike në shpella si p.sh. në Shpellën e Lul Ndreut, Shpellën e quajtur Buni i Vjetër etj. Në malet përreth mund të bëhen ekskursione dhe ngjitje malore për profesionist dhe jo profesionist. Flora është e shumëllojshme këtu, drurët e ahut dhe pishave kombinohen me shkurret. Gjenden një sërë bimësh mjekësore si sanza, akacja, arrat, bar veshi, bliri, salepi etj. Në Vukël shumë interesante janë Burimet e Vuklit, të cilat janë shpallur monumete të natyrës. Fshati ka burime të shumta ujore, ku më e rëndësishme është gurra e Pepushajve. Për të apasionuarit pas speologjisë, ky fshat ofron shumë shpella interesante jo vetëm me vlera arkeologjike por dhe natyrore si p. sh. Shpella e Vushës. Shpella e Prekë Calit 5 km larg nga qendra e Vuklit është një ndër shpellat më interesante të fshatit. Flitet se nëpërmjet kësaj shpelle lidhet fshati Vukël me fshatin Selcë dhe në të rrjedh vazhdimisht ujë. Fshati është kryesisht blegtoral. Shtëpitë janë 1-2 katëshe prej guri me çati të mbuluar me tjegulla të kuqe. Festa e cila festohet në këtë fshat është Zoja Ndihmëtare në datë 24 Maj. Ku si çdo festë tjetër në Kelmend, miqtë mblidhen që në darkën e 23 Majit. Në ditën e festës pastaj mbidhen të gjithë tek kisha e fshatit, ku marrin pjesë

në kremtimin e meshës dhe shpeshherë bëhet dhe një log i vogël me këngëtarë, vallëtarë si dhe instrumentistë të zonës. Në fshat do të gjeni Bar - Kafë të vogla dhe dyqane rish*tjesh produkteve ushqimore.

NIKÇI

Në një largësi 15 km në lindje të fshatit Tamare, rrëzë bllokut të Shenikut rreth 600 - 850 m mbi nivelin e detit gjendet Nikçi, një fshat i vogël i komunës Kelmend. Dhe në këtë fshat natyra nuk është treguar kursimtare në ofrimin e bukurive të saj. Këtu do të gjeni shpella të bukura, burime që shpërthejnë në mes shkëmbinjëve, ujvara, peisazhe të bukura alpine etj. Do të deheni me aromën e luleve tek shëtisni ditëve pranverore. Ky fshat është si një ballkon. Nga majat e maleve të këtij fshati shihet "zemra" e Alpeve Shqiptare. Syri të kap pamje të bukura të majave të larta, blloqe vigane shkëmbore, liqene, bjeshkë e kullota të bukura alpine. Nga Nikçi me ndihmën e guidave vendase mund të kaloni në fshatrat turistike të Bogës, Thethit e Valbonës.

Lexo më shumë...

Ashtu si disa fshatra të tjera të Kelmendit, mendohet se emri i fshatit ka ardhë nga banori i parë me emrin Nili. Nikçi është një fshat i vogël i komunës Kelmend, i rrethuar nga male të larta. Në periudhën e vegetacionit i gjithë fshati gjallërohet dhe merr aromë të këndshme nga lulet e shërbelës, trumzës etj. Në këtë fshat ndodhet një pemë bliri shekullore. Kur çel ky bli, aroma e luleve të tij ndihet në gjithë fshatin. Këtu rriten bimë mjekësore si: sanza, lulet aguliçe, çaj i verdhë dhe rigon i kuq, të cilat ashtu si në fshatrat e tjera përbëjnë një burim të ardhurash për banorët e këtij fshati. Në Nikç ka shumë burime të pashterrshme me ujë të ftohtë. Ndër më të njohurat janë gurra e Musovatit, gurra e Komanit, Ledit, Jezercës etj. Ujrat kanë formuar shpella të bukura karstike si: Skurra e Gjaçkës, Shpella e Madhe, Shpella e Mrikelës etj. Objekte të tjera interesante natyrore, që gjenden në këtë fshat, janë pusët karstike, ujvara e Vizhnës si dhe Forca e Kelmendit, monument natyre si dhe vend me rëndësi historike. Pas Forcës së Kelmendit shpalosen majat e Bjeshkëve të Namuna. Atje mund të qëndrosh njëkohësisht në tetë pika kryesore: në Dobraçe, në Livadh të Bogës, në Surtë, në Koprrisht

të Ujk Carës, në Gropë të Bukur, në She të Bardhë, në Runicë dhe në Jezercë. Kudo sheh kulme majash si të gdhendura, vatra bore pranë kreshtave të dhëmbëzuara, blloqe vigane shkëmbore, liqene e florë të larmishme. Nga këtu nëpërmjet shtigjeve ose rrugëve të kafshëve mund të shkohet në fshatin Bogë, Theth e Valbonë. Përveç bukurive natyrore shumë interesante janë dhe objektet e ndërtuara nga dora e njeriut. Banesat për shembull janë të ndërtuara pranë njëra - tjetrës, dy katëshe prej guri me ballkon dhe çati të pjerrët alpine. Pranë ujrave të lumit Cem janë ndërtuar mullinjt e blojës, të cilat bluajnë grurin, misrin ose elbin, njësoj si më parë, sikur koha për to të kishte ndaluar. Festa që festohet në këtë fshat është Zoja Ndihmëtare në datë 24 Maj. Ngaqë fshati Nikç është një fshat i vogël këtu mblidhen shumë pak njerëz, por pavarësisht kësaj përsëri festa ka përmasat e duhura si në çdo fshat tjetër, ku nuk mungojnë miqtë dhe pritja e pakrahasueshme. Në fshat do të gjeni Bar - Kafe të vogla dhe dyqane rish*tjesh produktesh ushqimore.

LEPUSHA

Fshati Lepushë ndodhet 21 km larg Tamares dhe 10 km më në juglindje të fshatit Vermosh. Ky fshat gjendet 1200 m mbi nivelin e detit dhe vlerësohet si kryevepra e natyrës së Kelmendit. Ai shtrihet në një luginë të butë të veshur me gjelbërim, ku pranë saj ngrihen Bjeshkët e Namuna, vendikulindën legjendat dhe eposi i Kreshnikëve. Të pasionuarit pas speleologjisë këtu mund të gjejnë mjaft shpella interesante. Shtigjet e shenjuara do ju shpien në itinerare shumë të bukura. Në Lepushë do të provoni reçelin e boronicës dhe të luleshtrydheve të pyllit, rakinë e sanzës, etj. Do të argëtoheni në festën e "Logut të Bjeshkëve", ku do të njiheni me veshjet tradicionale, këngët e vallet e Kelmendit.

Emri i fshatit mendohet se rrjedh nga një bimë barishtore me gjethe të mëdha dhe lule të verdha që quhet Lëpushtra (*Caltha palustris*) e cila gjendet me shumicë në këtë fshat. Ky është fshati me reshjet më të mëdha të dëborës, trashësia e saj në male ka arritur deri 425 cm. Në majat e Bjeshkëve të Namuna dëborat qëndron gjatë gjithë vitit. Lugina e Lepushës është si një pistë natyrore për ski dhe ditët e shumta me dëborë e favorizojnë zhvillimin e këtij sporti.

Ky fshat dallohet për kontraste të mëdha të relievit, të cilat i japin asaj bukuri panoramike. Në këtë fshat mbizotëron gjelbërimi. Pyjet përbëhen nga dru ahu dhe halor. Në livadhe e kullota rriten shumë lloje bimësh e lulesh. Për vlerat floristike të këtij fshati studiuesi dhe paleonteologu hungarez Franc Nopça shkruante: "Njeriu mund të besonte që gjendej në pyllin e Vjenës, sikur të mos gjendej aty maja kërcënuese e Trojanit". Ky fshat është shumë i pasur me bimë mjekësore si: boronica, balsami, sanza, bar shpatorja, cermerdelli, dëllinja e kuqe dhe e zezë, etj. Përveç florës edhe fauna është e pasur.

Vlen të përmenden Shqiponja e malit (*Aquila crysaetus*) dhe Shkaba (*Gyps fulvus*), të cilat i ndërtojnë foletë në shkëmbinjët e Bjeshkëve të Namuna dhe që i kanë dhënë emrin vendit tonë "vendi i shqiponjave". Blloku i Shnikut, pjesë e Bjeshkëve të Namuna, i përbërë nga 17 maja mbi 2000 m sfidon alpinistët profesionist. Në këtë fshat ka disa bjeshkë të bukura siç është Bjeshka e Berizhdolit, e cila përbëhet nga kodra të buta dhe cirqe akullnajore të mbuluara me bar e boronica.

Gjithashtu bjeshkë e bukur është Bjeshka e Koprrishtit, në të cilën ndodhet hidromonumenti Burimet e Koprrishtit, ku uji del në kontaktin midis shkëmbinjve gëlqerorë me ata flishorë. Lepusha është shumë e pasur me burime ujore të pashtershme si dhe me shpella karstike... Në qafën e Predelecit, nga ku shihet një pamje e mrekullueshme e fshatit, zhvillohet çdo vit në muajin gusht "Logu i Bjeshkëve". Ky është një konkurs ku zgjidhet më e bukura e alpeve, e cila nuk vlerësohet vetëm nga bukuria fizike, xhubleta më e bukur por dhe nga aftësia e saj për të kërcyer. Kjo është një festë e gjithë Kelmendit. Festë e fshatit është festa e Festa e Zojes Ndihmëtare në muajin Maj, e cila është festë me karakter fetar. Akomodimi këtu mund të bëhet në hotelin e vogël të fshatit ose në bujtina. Në qendrën e fshatit, në të cilën kalon rruga kryesore, gjenden bare të vegjël dhe pak dyqane rishitjesh artikuj të ndryshëm. Jo i gjithë fshati mbulohet me valë të telefonisë së lëvizshme të kompanive shqiptare.

***Shënim:** Ky kapitull eshte i formular mbi bazen e studimit nga "Glnis"*

II. NATYRA E KELMENDIT

BJESHKËT E NAMUNA

Shtrihen në pjesën juglindore të Kelmendit dhe përbëjnë teritorin më të qartë edhe emërtimin e goditur të tyre. Në pamjen e lartë të tij. Ato janë të thata e të zhveshura, çka shpreh përgjithshme, Bjeshkët e Namuna kanë tiparet karakteristike të një blloku me një shtrirje tëpërgjithshme nga jugperëndimi në verilindje prej 13. 5 km. Elementët kryesor morfologjikë të këtij blloku janë kreshtat e mprehta të ndara prej gropave ndërmallore.

Në veriperëndim gropat kryesore janë: Gropa e Shterpave, ajo e Janës, e Kllogjenit, e Dobraçës e tjerë, kurse në juglindje janë lugu i Rumicës, gropa e Livadhit dhe ajo e Radohimës. Këto gropa janë në lartësinë afro 2000m dhe kanë tiparet e cirqeve të mëdhenj akullnajorë. Kurrizi midis majës së Langojeve (Lëpushë) dhe Shenikut (Nikç) formon një nga kreshtat më të mprehta e më të ashpra të këtyre Bjeshkëve. Kjo kreshtë kulmore përbëhet nga një sërë majash të mprehta piramidale ne forma nga më të ndryshmet e më të cuditshme, simaja e Langojve (2426m), maja e Liqenit (2450m), ajo Vukoçës mbi stanet e Vukoçës (2499m), e Prozhmit (2452m), maja e Cjapit (2412m) e tjerë, që ndahen midis në qëndër të Bjeshkëve të Namuna, ngrihet maja më e tyre Sheniku (2553m)Pothuajse pamje nga fshati Nikç ka një forme mjaft të butë, duke kontrastuar me atë të Prozhmit. Vetëm shpati verilindor dhe ai jugperëndimor kanë pamjen e rrepirave.

Në kreshtën kulmore të Bjeshkëve të Namuna, gjenden mjaft cirqe akullnajore të cilët e kanë skalitur atë, duke i dhënë pamje edhe më të ashpër. Mbulesa bimore në këtë bllok është e varfër dhe përfaqësohet kryesisht nga kati i ahut që shkon deri në 1600-1700m lartësi, pjesërisht nga dushku e rrobulli. Mbi lartësinë 1800 - 1900m kreshtat janë pothuajse tërësisht të

zhveshura. Tufa të vetmuara barërash alpine dalin aty këtu nëpër të çarat dhe gropëzat e shkëmbenjëve. Në këto shkrepë jetojnë disa kafshë të egra si dhija e egër, rrëqebulli, zardafi, ujku, dhelpër, kunadhja e tjera.

VARGMALI DUBINE-GOLISHE-BERIZHDOL

Shtrihet në veriperëndim të Bjeshkëve të Namuna, midis luginës së Cemit të Vuklit dhe asaj të Cemit të Selces. Në pamjen e përgjithshme gjatë gjithë shtrirjes së tij nga maja e Zagonit në jugperëndim e deri në Qafë të Berizhdolit në verilindje, ka një formë harkore me konkavitet nga jugu. Kurrizi vjen e zgjerohet nga vendi i bashkimit të dy Cemave (maja e Zagonit) e deri të Qafa e Berizhdolit, në kufij me Bjeshkët e Namuna.

Pjesa jugperëndimore e këtij vargu përbëhet nga rrëpira e gremina të njëpasnjëshme. Maja më e lartë në këtë pjesë është ajo e Dubinës me lartësi 1734m. Në verilindje kurrizi vjen duke u lartësuar deri sa arrin kulmin në luspën gëlqerore të Golishit 2022m. Nga maja e Golishit kjo kreshtë bie gradualisht mbi Gropat akullnajor të cilët përbëjnë fillimin e një dege të Cemit e Selcës. Në verilindje të Golishit ndodhen dy cirqe të Selcës dhe përroit të Dërshenës, degë e Cemit të vUKLIT.

Tek Qafa e Ponikut, vargmali kthehet nga lindja duke arritur pjesën kulmore në majën e Berizhdolit(1980m). Në shpatin verilindor të Berizhdolit ndodhen dy cirqe që janë të ruajtura mirë e që përbëjnë fillimin e përroit të Lëpushës e të Cemit të Selcës. Mbulesa bimore e këtij vargmali është e pasur me pyje ahu që shtrihen në lartësinë 1700-1900m. Në rrëpirat gëlqerore të shpatit veriperëndimor, midis Dubinës e Golishit, takohen edhe dru të rrallë si rrobulli (*Pinus heldreichi*) deri në 2000m lartësi. Në këtë vargmal ka mjaft kullota alpine.

LUGINA E CEMIT

Është një luginë mjaft interesante, pellgu ujëmbledhës i së cilës, brenda kufijve shtetërorë, ka një sipërfaqe prej 255 km², duke zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së Kelmendit. Lugina e Cemit formohet prej dy degëve mjaft origjinale, nga Cemi i Vuklit dhe nga Cemi i Selcës. Në dalje të fshatit Tamarë, këto dy degë bashkohen dhe formojnë luginën e vetme të Cemit.

LUGINA E CEMIT TË VUKLIT

Fillon nga lartësia 900m dhe ulet deri në 235m tek vend bashkimi me Cemin e Selcës. Në bazë të ndryshimeve morfologjike në këtë luginë dallohen qartë dy sektorë: sektori i sipërm, midis burimit dhe fshatit Vukël, ka tiparet e një pellgu. Në këtë pjesë lugina formon një hark me konkavitë nga jugu. Këtu, nga e djathta e luginës, takohen tre nivele tarracash akumulative, në të cilat është vendosur fshati Vukël. Sektori tjetër, ai midis Vuklit dhe Urës së Tamarës, ka tiparet e një luginë erozive. Në këtë sektor shtrati i luginës ngushtohet menjëherë duke formuar pragje e gjarpërime të shumta midis shkëmbinjëve karbonatikë.

LUGINA E LUMIT TË SELCËS

Kjo luginë fillon nga lartësia 1200m dhe ulet deri në 235m në vend bashkimit me Cemine morfologjike, ndahet në dy sektorë: Sektori i sipërm, Vuklit. Edhe kjo luginë në bazë të ndryshimeve midis burimeve dhe Gropave të Selcës dhe ai midis Gropave të Selcës dhe Urës së Tamarës. Në sektorin e sipërm lugina thellohet e zgjerohet gradualisht deri sa merr pothuajse tiparet e një pellgu midis flishit e gëlqerorëve në gropat e Selcës. Në dalje të Gropave të Selcës fillon sektori i poshtëm i saj, i formuar në shkëmbinj karbonatik, midis malit të Vilës nga e djathta dhe atij të Golishit nga e majta. Shpatet e luginës kanë pamjen e rrëpirave dhe karakterizohen nga një asimetri shumë e vogël. Gjatë shtratis të saj takohen një sërë pragjesh ku shtrihet dhe një pjesë e fshatit me të njëjtin emër. Midis Dobrinjës e Tamarës lugina ngushtohet menjëherë, shpatet ngrihen pjertas pothuajse simetrike mbi lumoren e cila zhytet 10 - 15m në tarracën që e shoqëron atë deri në Tamarë. Dy luginat e lartëpërmendura bashkohen me njëra tjetrën tek Ura e Tamarës, duke formuar një trung të vetëm që përfundon në luginën e lumit Moraça (jashtë kufirit shtetëror). Pas bashkimit kjo luginë merr tiparet morfologjike të luginës së lumit të Vuklit. Duke çarë gjithmonë masën e fuqishme të karbonatikëve në një thellësi 900-1000m, kjo luginë e parë nga Leqet e Hotit ka një pamje madhështore. Të dy luginat janë mjaft të populluara, ku qendrat kryesore të banimit janë: Tamara, Selca, Vukli, Nikçi, diluvionale e lumoret e këtyre luginave. Broja, Kalca e Kozhnja, të vendosura në tarracat



Pamje nga Lugina e lumit të Cemit



Pamje nga Lugina e lumit të Selcës

VARMALI MIDIS LUGINËS SË CEMIT TË SELCËS DHE ASAJ TË VERMOSHIT

Ky vargmal ka drejtim pothuajselindje - perëndim. Përveç luginës së Cemit të Selcës dhe asaj të Vermoshit (kufiri verior dhe jugor), ky varg kufizohet edhe me luginën e Skrobotushës në perëndim dhe atë të Lëpushës në lindje. Këto dy të fundit janë degë të djathta të lumit të Vermoshit). Në pamjen e përgjithshme ka formën e një katërkëndëshi të çrregullt, rrethuar nga të gjitha anët nga rrjeti hidrografik i luginave lumore të lartpërmendura. Në perëndim maja më e lartë është ajo e Vilës 2180m, ndërsa në lindje maja e Grebenit 1840m lartësi. Shpati verior i këtij vargmal bie gradualisht në luginën e Vermoshit me një pjerrtësi mestare. Shpati jugor ka formën e një amfiteatri gjigant natyror. Në këtë shpat ka mjaft gropa karstike, kurse në lartësinë 1500m ndodhen disa cirqe akullnajor, ku spikat në reljev veçanërisht cirku i Grebenit (rreth 2 km²) në formë tipike të një freskoreje. Në juglindje ky vargmal mbyllet përfundimisht në Qafën e Predelecit(1320m), e cila përbën një kufi natyror klimatik dhe hidrografik. Në lindje lugina e Lëpushës e ndan atë nga vargu i Trojanit, i cili shtrihet gjatë kufirit shtetëror, midis Bjeshkëve të Namuna në jug dhe kurrizit të Marlulës në veri. Në qendër Trojani arrin deri në 2195m e ulet gradualisht në skajet e përbërë nga flishi. Mbi lartësinë 1600 - 1700m shpatet janë modeluar nga cirqe akullnajore që përbëjnë edhe fillimet e Përroit të Lëpushës. Meqënëse pjesa dërmuese e këtyre dy akullnajore, që përbëjnë edhe fillimet evargjeve përbëhet nga flishi, mbulesa bimore këtu është mjaft e dendur e përbëhet kryesisht nga ahu dhe rrobulli.

LUGINA E VERMOSHIT

Kjo luginë ka drejtim veriperëndim juglindje. Në pamjen e përgjithshme ka pamjen e një korite tipike, me krahë të gjërë të cilat zbresin gradualisht drejt fundit pak a shumë të sheshtë të saj. Lugina e Vermoshit fillon nga 1300m lartësi ku nis përroi i Skrobotushës deri në lartësinë afro 1000m, pak nën grykëderdhjen e përroit të Lëpushës. Ajo zgjerohet menjëherë sapo futet në vendin tonë, në Velipojë të Vermoshit, duke marrë tiparet e një lumi fushor. Këto tipare ajo i ruan deri në dalje

të fshatit Vermosh, me një lumore deri në 150 - 200m. Në dalje të fshatit Vermosh e deri sa përfundon jashtë kufirit të vendit tonë (Gerçarë), ku merr edhe luginën e përroit të Lëpushës, ajo ngushtohet për shkak të futjes së saj në shkëmbenj gëlqerorë. Faktorët natyror, klimatiko tokësor të kësaj luginë, kanë kushtëzuar zhvillimin e një bimësie të pasur me pyje ahu e livadhe subalpine, të cilat krijojnë një dekor të gjelbër mjaft tërheqës për vizitorët. Në luginë shtrihet fshati piktoresk i Vermoshit, me ndërtime tipike alpine dhe me një pejsazh antropogjen të larmishëm.

VARGMALI MARLULË - MAJA E BOJËS

Ky vargmal shtrihet nga e majta e luginës së Vermoshit dhe përbën skajin më verior të vendit tonë. Ky vargmal ka drejtim veriperëndim-juglindje. Ai fillon me majën e Zabelit(2056m) lartësohet menjëherë tek maja e Marlulës(2135m), dhe mbas qafës tektoniko - erozive të Mojanit(2186m) dhe maja e Madhe (2195m). Prej këtu ai ulet gradualisht derisa mbyllet përfundimisht në qafën e Lipovicës. Mbi lartësinë 1700 - 1800m ka mjaft cirqeakullnajore. Në verilindje të këtij vargu, i ndarë nga lugina e Përroit të Harushës, shtrihet vargmali i Zhihovës me lartësi 2174m. Gjatë kulmit të këtij vargmali, kalon vija kufitare me Malin e Zi, dukeshënuar njëherazi edhe skajin verior të vendit tonë. Midis tij dhe malit të Seferçës shtrihet lugu akullnajori Dolit me tiparet e spikatura të një korite dhe bukuritë rrallë. Kurse lugina e Përroit të Livadhit të Harushës, e cila ndan dy kurrizet e lartpërmendura, paraqitet mjaft e thellë me tiparet e një kanioni në disa sektorëtë saj dhe në trajtë të shkallëzuar. Rrëpirat gëlqerore të shpateve të saj veçanërisht ato nga shpati verior i Marlulës janë spektakolare për ngjitje alpinistike. Mbulesa bimore e këtij vargu malor është mjaft e pasur dhe përfaqësohet nga pyjet e ahut dhe kullotat alpine.

TAMARA

Tamara është një emër i dhënë nga femrat që rrjedh më së shpeshti nga emri biblik "Tamar", që do të thotë "data" (fruti), "palma e datës" ose "palma". Në vendet e Evropës qendrore dhe lindore si Armenia, Kroacia, Republika Czecheke, Gjeorgjia, Hungaria, Maqedonia e Veriut, Polonia,

Rusia, Serbia, Sllovenia dhe Ukraina ajo ka qenë një emër i zakonshëm për shekuj. Në Australi ishte shumë popullor nga vitet 1960 deri në vitet 1990.

Në Shtetet e Bashkuara, emri ishte mjaft i zakonshëm nga fundi i viteve 1950 deri në mesin e viteve 1990, i forcuar nga popullariteti i filmit Tammy dhe Bachelor (Tammy është zakonisht një pseudonim për Tamara). Në SHBA shumica e vajzave me emrin Tamara kanë lindur në vitin 1970 dhe numri i Tamarasve të lindur në vit ishte më i madh se 1.000 deri në vitin 1996.

Emri tani është mjaft i pazakontë në SHBA: në vitin 2010, emri ra nga lista e Top 1000 SSA Baby Name, me më pak se 250 vajza për fëmijë të quajtur Tamara atë vit.

Fjala / emri Hebraisht

Do të thotë "data" (fruti), "palma e datës", "palma".

Emra të tjerë

Emrat e lidhur Tammy, Tamy, Tami, Tammii, Tam, Tamera

Variacionet përfshijnë Tamar, Temara, Tamra, Tamera dhe Tamora. Në Amerikën e Veriut Tamara është shqiptuar në mënyrë tipike / 'tæmərə /; në Mbretërinë e Bashkuar dhe Australi ndonjëherë shqiptohet si / tə'mɑ:rə /; dhe në Rusi / tɐ'mɑ:rɐ / (shkruar Тама́ра). Në arabisht shqiptohet / tæ'mæ:ræ / (shkruar قرامت ای ارامت). Nofka më e zakonshme amerikane për Tamara është Tammy ose Tam, por pseudonime të tjera ekzistojnë, si Tatia (თათიას) Tamar (თამარ) Tamuna (თამუნა), Tamari (თამარი), Tamriko (თამრიკო) ose Tako (თაკო) në Gjeorgji, Toma në Rusi, Mara, Tama ose Tara.

Një dukuri e dukshme e emrit 'Tamara' në letërsi është një personazh në Titus Andronicus të Shekspirit. Në këtë shfaqje, Tamora është një grua ambicioze dhe hakmarrëse. Djemtë e saj planifikojnë të përdhunojnë vajzën e Titit Andronicus dhe Tamora refuzon kërkesat e vajzës për t'i ndaluar ato. Titi, në shenjë hakmarrjeje për përdhunimin brutal dhe shpërfytyrimin e vajzës së tij, vret të rinjtë, i ka pjekur në një byrek dhe i shërben byrekut Tamorës. Titus i thotë asaj që sapo i ka ngrënë djemtë e saj menjëherë para se ta vriste.

- Tamara Al-Gabbani, stiliste e modës Emirati
- Tamara Braun, aktore amerikane e operave sapun
- Tamara Buciuceanu, aktore rumune
- Tamara Bunke, e njohur më mirë si Tania Guerrilla, një revolucionare komuniste
- Tamara Danz, këngëtare gjermane e rrokut
- Tamara Degtyaryova (Rusisht: Тамара Васильевна Дегтярёва; 1944 - 2018), aktore skenike, televizive dhe filmi ruse
- Tamara Dobson, aktore dhe modele afrikano-amerikane
- Tamara Drasin, këngëtare-aktore me origjinë në Ukrainë
- Tamara Ecclestone, socialite anglisht-serbe, personalitet dhe model televiziv
- Tamara Feldman, aktore amerikane
- Tamara Georgijev, basketbollistja serbe
- Tamara Gverdsiteli, këngëtare, aktore dhe kompozitore nga Gjeorgjia-Ruse, Artiste e Popullit e Ingushetia, Georgia dhe Rusia.
- Tamara Jaber, këngëtare Australiane
- Tamara Jones, këngëtare dhe aktore
- Tamara Karsavina, balerina ruse
- Tamara Johnson, volejbolliste e brendshme amerikane
- Tamara Larrea, volejbollistja e volejbollit Kuban në plazh
- Tamara de Lempicka, piktor i artit deco polak
- Tamara Maria Kler ose Tamara Hunkeler, DJ Zviceriane e njohur me emrin e saj skenik Dinka
- Tamara Marthe, e njohur si Shy'm, këngëtare franceze
- Tamara McKinney, skiator amerikan
- Tamara Mello, aktore amerikane
- Tamara Mellon, president dhe themelues i kompanisë së këpucëve të stilistëve Jimmy Choo
- Tammy Faye Messner, ylli televiziv amerikan dhe ylli i realitetit TV
- Tamara Metal, bluzë e lartë olimpikë në Izrael dhe bluzë e gjatë dhe kapiten i ekipit kombëtar të basketbollit të Izraelit
- Tamara Mkheidze, arachnolog gjeorgjian
- Tamar i Xhorxhisë, Mbretëresha e Xhorxhisë

- Tamara Moskvina, çifte ruse e trajnerit në figura
- Tamara Gorski, aktore kanadeze
- Tamara Moss, model indiane
- Tamara Gräfin von Nayhauf, prezantuese e televizionit gjerman
- Tamara Pamyatnykh, pilotja luftëtare sovjetike gjatë Luftës së Dytë Botërore
- Tamara Radočaj (lindur 1987), basketbolliste serbe
- Tamara Rojo (lindur 1974), balerine spanjolle, drejtore artistike e Baletit Kombëtar Anglez
- Tamara Salman, dizajner me origjinë nga Iraku
- Tamara Macarena Valcárcel Serrano (lindur në 1984), këngëtare spanjolle e njohur si Tamara
- Tamara Sher, psikologe amerikane
- Tamara Sky, DJ dhe model
- Tamara Taylor, aktore kanadeze
- Tamara Todevska, këngëtare e muzikës pop
- Tamara Toumanova, balerina dhe aktore nga Gjeorgjia-Armene, aktive në Paris dhe Hollywood
- Tamara Tunie, aktore amerikane
- Tamara Venit-Shelton, autore amerikane dhe profesore e historisë Amerikane
- Tamara Ėitmer, aktore dhe modele amerikane
- Tamara Diane Ėimer, e njohur si Isis Gee, këngëtare amerikane

URA E TAMARES

Në komunën Kelmend , apo me sakte në qendrën e sotme të kësaj komune në Tamare, gjendet një Ure me emërtimin Ura e Tamares- Kjo veper qytetrimi e zhvillimi është e ndërtuar mbi lumën Cem të Vuklit, në një distancë rreth 75 metra para se të bashkohet cemi i Vuklit me degen tjetër



te lumit (Cem), Cemin e Selces. Gojdhenat qe qarkullojn edhe sot tregojne per nje ndertim disi te vonshem te kesaje Ure.

Keto gojdhena na cojne rreth vitit 1775, kur Bushatelinjet drejtonin Pashallekun e Shkodres, ku bente pjese edhe Nahija (Komuna) e Kelmendit. Ndertimi apo rindertimi modern i Ures i kushtohet nje gruaje me emrin Tamara qe thuhet se ishte bashkeshortja e Pashait te Shkodres (mendohet e Karamahmut Pash Bushatliut). Ne ato kohe thuhet se ura mbi lumin Cem (te Vuklit) ishte shume e dobte, gje e cila sillte shkaterrimin e herëpashershëm te kesaje ure nga rreshjet dhe ujerat e rrembyeshme te lumit.

Nje rast i till i shkaterrimit te ures kishte ndodhur kur gruaja e Bushatliut te sipercituar po kthehej nga gjinia e saj, thuhet nga Mali i zi. Deri sa u "rindertua" me mjete rrethanore ura mbi Cemin e Vuklit, gruas te bushatliut ju desht te presin disa dite.- Kjo vones kishte merzitur Tamaren dhe bashkeshortin e saj. Tamara me tu kthyer ne Shkoder nderhyri tek i shoqi (Pashai i Shkodres) i cili siguroi fondet per ndertimin e Ures-- Kur perfundoi se ndertuari Ura , per nder te gruas qe beri te mundur kete ndertim, ju dha emri "URA E TAMARES".

Ne gojedhene thuhet se kete emer e mori edhe Vendi, qe nder shekuj kishte sherbyer me Hanet e tij si "qender" pushimi per rrugetaret qe donin te kalonin nga Shkodra e me gjere per ne trojet e tjera te Shqiperise Etnike si ne Guci, Plave e me tej. Me emrin e kesaj Ure jane te lidhura shume ngjarje e data te historise se Kelmendasve, por ne po kujtojmë vetem DY: Betejen antiotomane te vitit 1911 (qe ne histori njihet si beteja te Ura e Tamares), dhe luften mbrojtese apo rezistencen antikomuniste te Kelmendit, qe e ka fillesen prane kesaje Ure ne fillim te vitit 1945, qe shpesh ne histori shkruhet "Lufta e Tamares" e tjer... Gjithsesi Ura e Tamares si te gjitha veprat ndertimore shumeshekullore u eshte neneshtuar rikonstruksioneve te nevojshme nder mote, duke i ndryshuar disi pamjen per mire Ures , por keto rikonstruksione nuk i kane ndryshuar trashigimin e vlerave te zhvillimit e qytetimit, qe rrezaton ne historine shumeshekullore te Kelmendit e me gjere Ura e Tamarës.

III. KËLMENDI NËPËRMJET STATISTIKAVE

POPULLSIA SIPAS GRUPMOSHAVE - KELMEND QERSHOR 2000

Nr.	Grup mosha	Datëlindja	Nr i banorëve	Në %
	Vjeç	vitet		
1	1 - 4	1999 - 1995	387	6.2
2	5 - 9	1994 - 1990	593	9.6
3	10 - 14	1989 - 1985	597	9.6
4	15 - 19	1984 - 1980	577	9.3
5	20 - 24	1979 - 1975	574	9.3
6	25 - 29	1974 - 1970	514	8.3
7	30 - 34	1969 - 1965	516	8.3
8	35 - 39	1964 - 1960	432	7.0
9	40 - 44	1959 - 1955	368	5.9
10	45 - 49	1954 - 1950	271	4.4
11	50 - 54	1949 - 1945	258	4.2
12	55 - 59	1944 - 1940	266	4.3
13	60 - 64	1939 - 1935	253	4.1
14	65 - 69	1934 - 1930	175	2.8
15	70 - 74	1929 - 1925	179	2.9
16	75 - 79	1924 - 1920	102	1.7
17	+ 80 vjeç	nen 1919	131	2.1

Siç shihet nga tabela e mësipërme, popullsia 0-1 vjeç ka 4190 banorë nga 6139 gjithsej, që ka Kelmendi ose 67. 6 % e popullsisë së nxjerrë në muajin Qershor të vitit 2000 nga regjistrat e Gjendjes Civile Tamarë.

**POPULLSIA SIPAS GRUPMOSHAVE
E FSHATRAVE - Qershor 2000**

Grupmosha	Datëlindja	Vermosh	Lepushë	Selcë	Tamarë	Broja	Kozhnjë	Vukël	Nikç
01 - 04	1999 -1995	70	32	78	38	36	16	88	29
05 - 09	1994 -1990	121	38	112	47	68	26	133	48
10 - 14	1989 - 1985	140	42	113	56	57	13	119	57
15 - 19	1984 - 1980	147	37	117	55	63	8	102	48
20 - 24	1979 - 1975	136	33	112	69	58	13	99	55
25 - 29	1974 - 1970	125	39	118	55	38	8	94	37
30 - 34	1969 - 1965	128	34	82	47	56	21	109	109
35 - 39	1964 - 1960	107	40	75	41	48	13	74	34
40 - 44	1959 - 1955	98	31	74	45	30	7	53	30
45 - 49	1954 - 1950	69	17	51	35	22	7	5	17
50 - 54	1949 - 1945	66	18	55	21	25	5	44	24
55 - 59	1944 - 1940	75	14	47	18	31	5	55	21
60 - 64	1939 -1935	52	27	46	19	37	7	46	19
65 - 69	1934 -1930	38	15	38	11	20	5	35	13
70 - 74	1929 - 1925	42	13	30	12	22	8	33	19
75 - 79	1924 -1920	19	4	21	11	14	4	22	7
+ 80	1919 -	34	14	20	9	16	3	25	10
Shuma		1467	447	1189	589	641	169	1184	567

Nëqoftëse do të llogarisim popullsinë sipas bajraqeve që shpesh këto kohët e fundit u pëlqen Kelmendasve që të thonë: Bajraku i Selcës, e cila përmbledh fshatrat e Tamarës, Selcës, Gropës, Vermoshit përmbledh një popullsi prej 3384 banorësh. Bajraku i Vuklit e cila përmbledh fshatrat Vukël, Lepushë, Kozhnjë përmbledh një popullsi prej 2502 banorësh. Bajraku i Nikçit përmbledh fshatrat e Nikçit, Brojës, Budaqit, është më e vogla me 1297 banorë.

IV. ORGANIZIMI TRADICIONAL I KELMËNDIT

ANAS, BAJRAK, BAJRAKTAR, BESA E KELMËNDIT, FISI, HISE, KANUNI, KATUN

ANAS: Janë banorë vendas të një katundi. Kjo fjalë rrjedhë nga ana fjala standarte e gjuhës shqipe anë. Ana, ka kuptimin e njerëzve që i përkasin një ane gjeografikisht e percaktuar mirë. Ata janë të vjetër në atë vënd. Në shumë raste anasit kanë mbajtur krah me njerat nga mahallet e medha të katundit, kjo sipasojë e numrit të popullsisë dhe forces ekonomike. Keto familje me mbiemra të ndryshem të gjitha katolike por që nuk kanë një origjinë të saktë të tyre. Një gjë është e pranuar se ata nuk rrjedhin nga një baba i vetëm për të cilin flasin gojëdhënat se është krijuar Kelmëndi. Por edhe për to pretendohet një prejardhje më e vjeter se sa është krijuar vetë Mali i Kelmëndit nga një baba i vetëm. Nga shume burime dilet në konkluzionin se ata janë të ndodhur para krijimit të mehallëve të medha.

BAJRAK: (fjalë turke) Por në kuptimin e gjuhës shqipe kupton flamurin. Më ndryshe fisin (që në gjuhën e kelmëndasve është përdorë fis ose mahallë) që udheheqë. Një grup që marshon nën një flamur të vetëm, quhet bajrak, duke shtuar emrin e rajonit, fshatit në të cilin banon. Bajraku ka qënë një fis (mahallë) të cilet kanë qënë të bashkuar rreth një flamuri në një territor të percaktuar mirë fisnor. Zakonisht të gjithë burrat e një bajraku i përkasin një fisi. Por në Kelmënd ka një deviacion nga e pergjithëshmja në malësi, kjo ndoshta nga territori i hapur dhe i thyer dhe veshtersitë e komunikimit drejtimit dhe nderlidhjes sepse në kater bashkesitë njerzore që kelmëndasit i kanë quajtur BAJRAQE

e keto kanë qenë të përbera nga fise të ndryshme të përbëra nga mardhënje të ndryshme të gjakut dhe të gjyshërve e stërgjyshërve kanë pasë BAJRAKTARIN e vet. Selca, Nikçi, Vukli dhe Boga janë quajtur bajraqe me fise e mehallë të ndryshme në përbërje por të drejtuara nga një bajraktar. Bajraquet janë organizim i pushtetit në viset e malësisë nga pushtuesit turq. U duhej administrimi vëndas i ketyre anëve ngaqë edhe ata vetë nuk kishin mundësi ose më mirë nuk u interesonte që të shpenzohej mundë, kohë e njerëz për në ato vise për administrim dhe drejtim, ekonomik, politik dhe ushtarak. Duhet përmendur se malësoret e Malësisë Madhe pavarësisht se ku kanë jetuar, në fushe apo në vise malore, në kodrinat e buta apo në bregdet, emrin malsorë, "Mal", "Klan" apo "Fise" i kanë ruajtur si përcatuese të prejardhjes së tyre. Pershembull, "Mali i Kastratit", "Mali i Hotit", "Mali i Shkrelit", "Mali i Kelmëndit" etj pavarësisht se munde të jenë kater ose me shumë breza të lindur në Shtoj të Ulqinit por ata i thonë vetës, "malsorë të Shkrelit" ose Seljane etj. Qyshë në mesjetën e hershme organizimit territorial nëpër Kelmënd filluan të quhen (në fillim të vetthirren "Mal" në kuptimin fisnor të përhapjes së popullsisë. "Mali i Vuklit" pra malsoret që kanë prejardhjen nga fshati Vukel pavarësisht e së ciles vllazni ishin, "Mali i Selces", "Mali i Nikçit" dhe "Mali i Boges". Kelmëndi deri në vitin 1860 ka qenë një bajrak, ka pasë një bajraktar të emruar dhe çertifikuar nga prëndoria Osmane se pa njohjen e turqeve ai nuk ishte bajraktar dhe nuk kishte forcen e drejtimit dhe pushtetit. Pas këtij viti meqëse ishte rritë popullsia dhe vëndosja gjeografike ishte shumë e gjërë, Kelmëndi është ndarë në pesë bajraqe; Selcë, Vukël, Nikç, Boge dhe Vuthaj si nëndarje e bajrakut të Nikçit.

BAJRAKTAR: Ishte udhëheqësi ushtarak i bajrakut (Selce, Nikç, Vukel, Boge), mbajtës i flamurit në betejë - Ai po ashtu ishte dhe mbikqyrës i zbatimit të ligjeve të bajrakut. Pozita e bajraktarit në Kelmënd është trashëguar nga i ati tek i biri, ose tek një trashëgimtar mashkull. Përgjithësisht në Kelmënd ka pasë pushtet dhe është trajtuar gjithëmonë si i pari i bajrakut. Bajraktari ishte i vetmi person që mund ta ngrinte flamurin e bajrakut në betejë dhe tu printe burrave në luftë. Për tu bërë bajraktar kishte dy rrugë; *bajraktari mund të ishte nga vëllëzëri*

të medha dhe të fuqishme ekonomikisht dhe me shumë mëshkuj dhe për ketë duhej së paku kater brezni që të shquheshin në keto drejtime ose të emruar nga qeveria Turke si njerëz të besuar të saj. Qeveria turke ata i shperblente me toka, grada dhe nishane (medalje). Po ashtu u besonte flamurin dhe i armatoste me armet më të mira të kohës. Bajraktari kishte të drejtën e kushtrimit për mobilizim në luftë. Ai merrej me sigurimin e rëndit dhe qetësise, mbledhjen e taksave, pajtimin e gjaqeve, marrjen e vendime në kuvende të fshatit etj. Çdo bajrak, pra bajraktari kishte simbolin dhe flamurin e bajrakut që përfaqësonte dhe keto ja jepte qeveria Turke mbasi i kishte aprovuar më përpara dhe kishte arshivuar në adminstratën e saj më të lartë. Me të gjitha ato që kemi konstatuar gjatë studimit tonë del se bajraku dhe bajraktari ishte vetëm një formë qeverisje locale në kuptimin ushtarak dhe administrative gjithmonë në shërbim të Prëndorise Osmane.

BESA E KELMËNDIT: Ka pasë kuptimin e fjalës së nderit, ishte një zotim, betim, armëpushim, paqe që është arritë në mes dy palëve. Prandaj është folë për besën e burrit, për njeriun me besë, për besën e shqiptarit. Për besë të burrit dhe është dhënë dora e ka marrë fund çështja për të cilën mund të jetë diskutuar gjatë.

FISI: Është një bashkësi individesh të cilet e kanë prejardhjen sipas degës mashkullore nga një stërgjysh i përbashkët. Nuk duhet ngatërruar me bajrakun sepse ai ka më shumë kuptimin e fisit sipas territorit-Anetaret e fisit kanë prejardhje të njëjtë gjaku e në këtë menyrë ata nuk mund të martohen brënda fisit. Fisi ngandonjëherë është perbërë nga disa barqe dhe kur nuk ka raporte të aferta gjaku edhe është lejuar martesë. Fis quhet Kelmëndi mbasi thuhet se ka prejardhje ng një çift martesor.

HISE: (Më së shumti pasuri e paluajtëshme) Është pjesë e tokës, shtëpisë, pasurisë kur ndahet apo një trashëgimi. Hisja në Kelmënd përgjithesisht i ka takuar një biri të martuar me familje por edhe një pjestar familje i ndarë ka gezuar të drejtën e hises (pasurisë së paluajtëshme)

KANUNI: Fjalë turke që do të thotë ligj zakon, rregull, kod i ligjit. Kanuni ka qënë i trashëgueshem dhe është deri në ditët tona. Por në

Kelmënd ka pase dhe marrveshje të bazuara në Kanun të votuara në bajraqe të cilat janë quajtur Usulle

KATUN: I zëvendësuar me emrin: fshat ka kuptimin e vëndbanimit, ka edhe një kuptim të bashkësisë së disa barinjëve të cilat ishin si bërthamë e një mahalle

BAJRAKU I SELCËS

Nga thellësia e historisë thuhet se popullsia e kësaj mëhale është nga vëllai i madh i fisit të Kelmendit: Seli. Besimi fetar është katolik. Popullsia shtrihet në një territor të gjerë gjeografik; në luginën e Cemit, të Selcës dhe atë të luginës së Vermoshit. Kohë më parë janë vendosur në Velipojë të Nënshkodrës, Mal të Gjymtit, në fushat e Lezhës. Në vitet 1990, ka pasur lëvizje pa kthim në drejtim të ShBA - së dhe sidomos në shtetet e Neë Yorkut dhe të Michiganit.

Bajraku i Selcës ka të konsoliduar bajraktarin, i cili është nga mëhalla e parë e Pëllumbajve dhe atë të Vojvodës, nga mëhalla e Bujajve. Në bajrakun e Selcës festohen dy festa lokale: Për fshatrat Tamarë, Selcë, Gropat e Selcës, festohet Zoja Rruxare, që bie me 7 Tetor. Më përpara ka qenë festuar Shën Kelmendi, por duke qenë se bie vonë, në vjeshtë dhe ka pasë rrezik për rreshje dëbore e bllokim rruge, e për pasojë kanë mbetë miqtë në shtëpi të mikut, kryesia e fshatit e ka ndërruar festën lokale të fshatit. Kurse Vermoshi megjithëse janë të gjithë Seljanë, festojnë Shën Gjonin me 29 Gusht. Mëhallet e Selcës janë 12, të cilat po i cekim një nga një sipas renditjes tradicionale që i bëjnë vetes Seljanët.

1. **PËLLUMBAJT.** Kjo mëhallë që është më e madhja e Selcës, nga e cila është edhe bajraktari janë edhe këto barqe: Nikmartinaj, Macaj, Vukmartinaj, Hasanaj, Mardakaj. Kjo mëhallë veron në: Seferçe, Livad të Harushës, Përbicë, Jeshnicë. Varret i kanë si mëhallë në: Maliaj (Kisha e Shën Pjetrit) Kisha e Selcës dhe në Vratë.
2. **BUJAJ.** Kjo mëhallë që është e dyta nga ka qenë dhe Vojvoda i Selcës, janë këto barqe: Pepaj, Rudaj. Gjokaj, Laduraj. Kjo mëhallë

veron në Jeshnicë, Përbicë, Morinë, Seferçë. Varret i kanë si mëhallë në Vratë (Ladurajt), Kisha e Selcës, Maliaj (Kisha e Shën Pjetrit).

3. **RADETINËT.** Kjo mëhallë që thirret dhe Tinaj, veron në Vilë, Gropa të Dolit, Seferçe, Greben.
4. **NIKCIRAJT.** Kjo mëhallë thirret dhe Merçanaj, Naçaj. Banorët e kësaj mëhalle verojnë në Greben, Traboin e Seferçe.
5. **VUKTILAJ.** Kjo mëhallë thirret me emrin Tilaj e Vukaj. Verojnë në Greben, Liqej Vajushe, Seferçe. Varret i kanë në Velan, Vratë.
6. **VUSHMAQË.** Thirren me emrin Vushaj. Verojnë në krahun lindor në Morinë, Greben, Teperçe. Varret i ka kjo mëhallë te Kisha e Selcës, Javorr, Maliaj.
7. **NIKGJOKAJ.** Mëhallësit thirren me emrin Shqutaj. Verojnë në Morinë, Traboinë, Greben, Lipovicë. Varret te Kisha e Selcës dhe Maliaj.
8. **DEDGJOKAJ.** Nga kjo mëhallë sot nuk jeton asnjë familje. Verojnë në Mruzi, kufi me Jeshnicë e Vilë. I kanë varret të parët e tyre tek Kisha e Selcës.
9. **REXHAJ.** Kjo mëhallë veron në Greben e Traboin. Varret, te Kisha e Shën Pjetrit.
10. **LELÇAJ.** Kjo mëhallë veron në Greben, Traboin, Mruz. Varret i kanë tek Kisha e Selcës dhe tek Kisha e Shën Pjetrit në Maliaj, Vermosh.
11. **GJONOVIQ.** Kjo mëhallë thirret dhe me emrin Mitaj. Verojnë në Ponik, Seferçe. Varret i kanë në Breg të Velanit dhe në Vratë.
12. **VRATASIT.** Kjo mëhallë përmbledh Hysaj e Lumaj. Verojnë në Golishë Liqej, Kersh i Djegun, pas Majës së Bojës. Varret i kanë në Kodër të Hysë, Vratë.

FALENDERIME

Në realizimin e këtij libri më kanë ndihmuar duke më njohur me fakte të jetuara, z. Zef Kolë Volaj, ndër të parët intelektualë që kanë kontribuar për Kelmendin. Dua që t'a kujtoj me këtë rast me shumë nostalgji këtë burrë serioz dhe shumë të saktë.

Gjithashtu dhe fotografën e apasionuar z. Llesh Volaj, i cili është autori i shume fotografive të këtij libri, dhe Albano Volaj të cilat e kanë pasuruar në mënyrë të ndjeshme materialin që përmban.

Faleminderit z. Gjeto Leka (Gjelaj) në Brojë, i cili më ka ndihmuar në kapitullin e "Përpyqjeve të Ura e Tamarës".

Falenderoj dhe zotërinjtë Ndue Zef Lumaj, Nikë Franin, Luk Dedën, Kolë Tolin, Mark Kapën, Nikollë Nilën, Luigj Caraj, Drane Volaj, Gaspër Deda dhe ish drejtoreshën e shkollës Marije Volaj, Ndoc Dedën e Shkrelit që më kanë ndihmuar për kapitullin e Prekë Calit dhe vështrim historik të Kelmendit.

Faleminderit nga zotrinjtë Gjovalin Lumaj dhe Gezim Naçaj që me kanë ndihmuar për historikun e pushtetit ekonomik dhe administrativ të Vermosh.

Falenderit z. Luigj Jaku (Nilaj) që me ka ndihmuar për historikun e pushtetit ekonomik dhe administrativ të Vukel Nikç.

Faleminderit z. Pjeter Dragu i cili me ka ndihmuar për historikun e pushtetit ekonomik dhe administrativ të fshatit Lepushe dhe konsulence për çështjet ushtarake në Kelmënd.

Një falenderim të veçantë për Frat Sergio Gazzea, i cili më ka dhuruar kompjuterin për të radhitur librin, botim i pare 1999.

Faleminderit dhe Z. Nikollë Mark Tomës, i cili më ka ndihmuar financiarisht për botimin e librit, botim i pare.

Faleminderit dhe z. Pjerin Prekes nga Pjetroshani i cili ka kontribuar per botimin e trete te ketij libri.

Faleminderit per zotrinjet Gjovalin Vushaj dhe Nikolle Curi Hysaj të cilet më kanë ndihmuar për botimin e trete te ketij libri

Mirënjohje për familjen time; bashkeshorten Valentinën dhe djemet e mije me bashkeshorte Roberti e Kristjana dhe Meriti e Anxhela që i kam pasë në krah e nxitje për ta punuar dhe për ta botuar librin, “Kelmëndi... dritë hije“ për të cilin punoj nga viti 1996. Ky është botimi i tretë i plotësuar.

AUTORI

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I.	KELMENDI	
-	Vështrim i përgjithshëm historik, shoqëror; dokat dhe zakonet	5
-	Një i huaj si krijues i Këlmendasve të sotëm	8
-	Ata që i dhanë formë historisë së Këlmendit.....	10
-	Vështrim për pesë fshatra të Këlmendit: Selcë, Tamare, Vukël, Nikç, Lëpushë	13
II.	NATYRA E KELMENDIT	
-	Bjeshkët e Namuna	20
-	Vargmali Dubinë-Golish-Berizhdol	21
-	Lugina e Cemit	21
-	Lugina e Cemit të Vuklit	22
-	Lugina e lumit të Selcës	22
-	Vargmali midis luginës së Cemit të Selcës dhe asaj të Vermoshit.....	24
-	Lugina e Vermoshit.....	24
-	Vargmali Marlulë - Maja e Brojës	23
-	Tamara.....	23
-	Ura e Tamarës.....	28
III.	KELMENDI NEPERMJET STATISTIKAVE	
-	Popullsia sipas grupmohave - Këlmend, qershor 2000	30
-	Popullsia sipas grupmohave e fshatrave, qershor 2000	31
IV.	ORGANIZIMI TRADICIONAL I KËLMËNDIT	
-	Anas, Bajrak, Bajraktar, Besa e Këlmendit, Fisi, Hise, Kanuni, Katun	32
-	Bajraku i Selcës.....	35

- Toponomastika e Selces (Vermosh).....	37
- Bajraku i Vuklit	41
- Prële Mema i Vuklit	47
- Bajraku i Nikçit.....	49
V. KELMENDI NEPER STATISTIKA	
- Objekte banimi në fshatrat e Këlmendit, qershor 2000	51
- Gjendja e blegtorisë në Këlmend, qershor 2000	53
- Lindjet dhe vdekjet në Këlmend (sipas spitalit Tamarë).....	55
VI. VËSHTRIME HISTORIKE	
- Memorandumi i Greçes. Kushtet historiko - shoqërore kur u mbajt Kuvendi i Greçes.....	56
- Memorandumi i krerëve të Bajrakut të Kelmendit dërguar autoriteteve britanike në Londër, më 26 maj 1913.	63
VII. FIGURA HISTORIKE	
- Nike Lekë Pepaj	66
- Gjeto dhe Dedë Çoku	67
- Gjeto Çoku.....	68
- Dedë Çoku	69
- Prekë Cali	75
VIII. NGJARJE HISTORIKE	
- Situata politike ne Qarkun e Shkodres perpara luftes ne mes forcave nacionaliste antikomuniste dhe njesive partizane.....	85
- Përpjekja e vitit 1945 tek Ura e Tamarës - lum gjaku mes shqiptarësh	90
- Raportime te kohes se luftes nga eksponentët kryesorë ushtarakë komunistë	97
- Komenti politik i eksponenteve te Brigades i Sulmuse	97
- Prekë Cali përballë partizanëve nga Jugosllavia dhe Shqipëria.....	98
- Ozna dhe Udba jugosllave	102
- Lista emërore e të vvarëve, të pushkatuarve dhe të vdekurve në burgje e kampe të diktaturës	105

- Partizanet e Brigades I Sulmuese të rënë në Kelmënd, janar-shkurt 1945.....	108
IX. BIBLIOGRAFI E SHKURTER ME EMRA TE CILET PËRMËNDEN NË KELMËND	110
X. HISTORI PUSHTETI NË KELMEND	
- Qendra adminastrive tamare.....	136
XI. ORGANIZIMI I JETES POLITIKE ADMISITRATIVE DHE EKONOMIKE NE VERMOSH (1945-1990)	
- Kryetaret e Keshillit Popullor.....	148
- Organizimi i jetes politike në Vermosh, 1945-1990	149
- Organizimi në kooperativen bujqësore Vermosh, 1967 -1990.....	149
- Një liste emrore e atyre që kanë mbaruar arsimin e mesem (dhe profesional 2-vjeçar) deri 1990 nga fshati Vermosh	152
- Një liste emrore e atyre që kanë mbaruar arsimin e larte 1945-1990 nga fshati Vermosh.....	154
- Organizimi i jetes politike, admisitrative dhe ekonomike ne Vukel-Nikç-Kozhnje.....	155
- Oragnizimi i kooperatives ne Vukel-Nikç-Kozhnje.....	156
- Keshilltarët e Keshillit të Komunes Kelmend nga fshati Vukel dhe kryetari përkates për gjithë Kelmëndin.....	161
- Organizimi i jetës politike, administrative dhe ekonomike në Nikç (1945-1990)	163
- Organizimi i jetes politike admisitrative dhe ekonomike ne Selcë	165
- Histori te administrates ne fshatin Lepushe.....	167
- Batalioni art mitralier në Predelec.....	171
- Zhvillimi i arsimit dhe shendëtësisë në Kelmend.....	173
XII. LËVIZJE TË VONUARA QË KUSHTUAN SHTRENJTË	
- Lista emërorë e personave të arratisur jashtë atdheut në vitet 1948 - 1990.....	183
- Të ikur nga tradhtia e policit Ahmet Nika, agent i Udba-s, shtator 1948	185

- Lista emërore e personave të burgosur politik në vitet 1948 - 1990.....	186
XIII. FUNDI I VITEVE 1980-te	
- Vitet tetëdhjetë - vitet e krizës së thellë.....	188
- Dhjetëvjeçari i fundshekullit	199
- Pluralizmi në Kelmend.....	203
- Komiteti ekzekutiv pluralist në Tamarë	210
- Zgjedhjet e vitit 1992, 22 marsi	220
- Zgjedhjet e 26 korrikut 1992 për pushtet lokal.....	222
- Rezultatet e zgjedhjeve për kryetar komune me 26 korrik 1992.....	225
- Periudha paszgjedhore	227
- Viti 1996 parlamenti shqiptar dhe zgjedhjet lokale.....	240
XIV. KULTURA ARTI DHE TRADITA NE KELMEND	
- Perbersit e veshjeve tradicionale te Kelmendit	249
- Folklori në Kelmend, mjaft i hapur dhe i parapëlqyer. Këngët e kreshnikëve	257
- Kërcimet malësorçe	258
- Shoqata kulturore - artistike “Kelmendi”	261
- Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje njerëzve me shpirt të madh artist.....	262
- Shkrimtarët, poetët, piktorët, gdhendësit, fotografët, janë vatër e artistëve të këtij vendi	269
- Monumenti i Prek Calit në Shkodër.....	272
- 1997 - Vit i mbrapshtë shqiptar.....	277
- Logu i Bjeshkëve	294
XV. FJALOR KELMENDAS ME FJALE SOT PAK TE PERDORSHME.....	
- Fjalë të rralla	
- Fjalë më pak në përdorim	314
- Fjalor bujqësor i Kelmendit	316
- Fjalor blegtoral i Kelmendit.....	317
BIBLIOGRAFI.....	
	320

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Dragu, Rush

Kelmendi... dritë hije : refleksione / Rush Dragu ;

red. Merit Dragu. - Shkodër : Fiorentia, 2023.

328 f. : me foto ; 17 x 24cm.

ISBN 9789928382269

1.Studime sociale

2.Malesia e Kelmendit

3.Shqipëri

908(496.5-3)